



This project is funded by
the European Union



MNE-ALB

IPA CROSS-BORDER COOPERATION PROGRAMME
MONTENEGRO-ALBANIA 2014-2020



Crna Gora
Ministarstvo javne uprave

PLANI LOKAL PËR PUNËSUESHMËRINË E TË RINJVE TË KOMUNËS SË ULQINIT

- DRAFT -

Ulqin, qershor 2022.





This project is funded by
the European Union



MNE-ALB
IPA CROSS-BORDER COOPERATION PROGRAMME
MONTENEGRO-ALBANIA 2014-2020



Crna Gora
Ministarstvo javne uprave

Përmbajtja

HYRJE	3
Kuadri institucional dhe normativ i politikës lokale të punësimit	4
Hulumtimet e kryera relevante për fushën e punësimit të të rinjve në komunën e Ulqinit	7
Arsimi në shërbim të punësueshmërisë më të madhe të të rinjve në komunën e Ulqinit	9
Plani lokal i punësimit të të rinjve për komunën e Ulqinit	12
Përcaktimi i qëllimeve dhe aktiviteteve të planit të veprimit	12
Plani i veprimit njëvjeçar për punësueshmërisë më të madhe të të rinjve nga Ulqini me tregues dhe vlerësim të resurseve të nevojshme	13
Hartimi planit për monitorimin e zbatimit të Planit Lokal dhe suksesit të tij	18





This project is funded by
the European Union



MNE-ALB
IPA CROSS-BORDER COOPERATION PROGRAMME
MONTENEGRO-ALBANIA 2014-2020



Crna Gora
Ministarstvo javne uprave

HYRJE

Të rinjtë janë kapitali njerëzor më me vlerë që posedon shoqëria moderne. Ata janë motori i ndryshimit, e tashmja dhe e ardhmja e shoqërisë. Edhe pse ata vetë janë një potencial për zhvillimin dhe përparimin e qytetit dhe të vendit ku jetojnë, të rinjtë individualisht ndejnë uljen e cikleve ekonomike dhe efektet e ndryshimeve të shpeshta. Ata janë gjithashtu viktima të një modeli biznesi fleksibël që përfshin një dozë të lartë pasigurie, me efekte të dukshme që i marginalizojnë ata dhe i përjashtojnë nga konkurrenca për punësim.

Gjithashtu, ndryshimet sociale dhe teknologjike kanë prodhuar një çrregullim progresiv të punës në disa aspekte që ndikon tek të rinjtë në një moment kritik të jetës së tyre: hyrjen në tregun e punës dhe hedhjen e themeleve të karrierës së tyre profesionale. Pikërisht në këtë dimension qëndrojnë shkaqet e ndryshimeve në punë që tregu duhet të adresojë në mënyrë gjithëpërfshirëse dhe të aktivizojë masat për t'iu përgjigjur këtyre ndryshimeve.

Prandaj, është jetike të merren masa për të parandaluar punësimin jo adekuat të të rinjve, për të stimuluar masat për arsimim, rikualifikim të mëtejshëm dhe zhvillim profesional, duke siguruar që të rinjtë të zhvillohen me dinjitet dhe mundësi të barabarta. **Plani Lokal për Punësueshmërinë e të Rinjve në Komunën e Ulqinit** paraqet një vlerë shtesë për vetëqeverisjen lokale, pas miratimit të Strategjisë së Punësimit të Komunës së Ulqinit 2021-2025. Ky është një dokument zhvillimor i cili thekson kujdesin ndaj të rinjve si kategori e një rëndësie të veçantë për të përmirësuar pozitën dhe punësueshmërinë e tyre në komunën tonë. Në këtë mënyrë, përiqemi të ndërtojmë një komunitet lokal që është më i drejtë, më gjithëpërfshirës, më i pasur dhe më i larmishëm, me pak fjalë, një shoqëri më të mirë. Si shoqëri, si qytet dhe si shtet, është detyra jonë t'u ofrojmë të rinjve mjetet, burimet dhe mundësitë që u nevojiten për të marrë pjesë në mënyrë aktive në konkurrencën e tregut, të zhvillojnë aftësitë e tyre dhe t'i kontribuojnë komunitetit.

Plani Lokal i Punësueshmërisë së të Rinjve të Komunës së Ulqinit është hartuar në kuadër të projektit *"Rrugët e zhvillimit të karrierës: Përgatitja e të rinjve nga Shqipëria dhe Mali i Zi për mundësitë e karrierës në sektorin e turizmit"* i cili zbatohet me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian në kuadër të IPA II Mali i Zi - Shqipëri. Programi i Bashkëpunimit Ndërkufitar 2014-2020, i cili menaxhohet nga Ministria e Financave e Malit të Zi. Projekti zbatohet nga organizata World Vision Albania në partneritet me OJQ Horizonti i Ri, si dhe shkollat e mesme "Vëllazërim-Bashkim" nga Ulqini dhe shkolla e mesme profesionale "Hamdi Bushati" nga Shkodra. Projekti bashkëfinancohet nga Ministria e Administratës Publike e Malit të Zi.





This project is funded by
the European Union



MNE-ALB
IPA CROSS-BORDER COOPERATION PROGRAMME
MONTENEGRO-ALBANIA 2014-2020



Crna Gora
Ministarstvo javne uprave

Kuadri institucional dhe normativ i politikës lokale të punësueshmërisë

Çdo vetëqeverisje lokale përpiket t'u sigurojë qytetarëve të saj kushte sa më të mira të jetesës. Një nga prioritetet e Vetëqeverisjes Lokale të Ulqinit është që të rinjtë të ndihen rehat në qytetin e tyre, të marrin pjesë në mënyre aktive në ngjarje dhe me mundësitë e tyre të kontribuojnë në proceset zhvillimore. Strategjitë lokale synojnë të përmirësojnë pozitën shoqërore të të rinjve dhe të krijojnë kushte që plotësojnë nevojat e të rinjve në fushën e interesit të tyre. Pothuajse nuk ka asnjë dokument strategjik apo plan veprimi që të mos mbrojë nevojën e krijimit të partneriteteve në të gjitha nivelet për të investuar vazhdimisht në zhvillimin e të rinjve.

Plani i Veprimit të Strategjisë së Punësimit për periudhën 2021-2025 pozicionon qartë të rinjtë si një çështje me rëndësi për komunitetin lokal dhe me një qasje universale parashikon bashkëpunimin ndërsektorial të aktorëve të politikave rinore. Plani Lokal i Veprimit për Punësueshmërinë e të Rinjve është një dokument që përcakton problemet themelore të të rinjve në komunën e Ulqinit, si dhe masat dhe aktivitetet konkrete për tejkalimin e tyre në mënyrë që të krijohen parakushte për përmirësimin e punësueshmërisë së të rinjve.

Shkalla e përfshirjes së të rinjve në Mal të Zi në programet e Entit për Punësim varet kryesisht nga lloji i programit të ofruar nga ky institucion, por në përgjithësi të rinjtë janë shumë të interesuar të përfshihen në këto programe. Të gjitha masat e ofruara shpesh janë të kufizuara për shkak të situatës financiare. Plani vjetor i punës dhe plani financiar i Entit për Punësim në fillim të vitit përcaktojnë të gjitha aktivitetet brenda fondeve që ka në dispozicion.

Nga pikëpamja e strukturës së moshës, të papunët nën moshën 30 vjeç përbëjnë pak më shumë se një të katërtën e numrit të përgjithshëm të të papunëve (26.5% në qershor 2020) në komunën e Ulqinit.

Enti i Punësimit të Malit të Zi - Zyra e Punës Ulqin, ndërmjetëson midis punëdhënësve dhe të papunësuarve dhe kryen aktivitete të tjera që kanë të bëjnë me punësimin: informim për mundësitë dhe kushtet e punësimit, orientimin profesional, përkrahjen për vetëpunësim-financim, punë publike, bursa, etj. Informimi i të rinjve për programet e Zyrës së Punës bëhet individualisht dhe në grup (ofruar nga ekspertët dhe këshilltarët për punësim nëpërmjet intervistave informative gjatë regjistrimit të parë, organizimit të seminareve motivuese, trajnimeve dhe formave të tjera të punës në grup), përmes tabelës së shpalljeve të Entit, broshurave dhe publikimeve, faqes së internetit, mediave, panaireve të punësimit etj.. Enti i Punësimit të Malit të Zi respektivisht, Zyra e Punës Ulqin, nuk mbajnë një evidencë të veçantë për numrin e të rinjve që kanë filluar biznesin e vet. Në bazë të njohurive joformale, nuk janë të pakta rastet kur të rinjtë kanë nisur biznesin e tyre duke themeluar një kompani, si dhe





This project is funded by
the European Union



MNE-ALB
IPA CROSS-BORDER COOPERATION PROGRAMME
MONTENEGRO-ALBANIA 2014-2020



Crna Gora
Ministarstvo javne uprave

sipërmarrje, ose janë përfshirë në një biznes familjar. Të shumta janë rastet kur të rinjtë kanë marrë një kredi për vetëpunësim dhe kanë nisur biznesin e tyre sezonal.

Gjatë periudhës së mëparshme, në Ulqin janë zbatuar masa të ndryshme të politikave aktive të punësimin, të cilat kanë të bëjnë me punët publike, aftësimin për punë, arsimimin e të rriturve dhe programe të tjera të punësimin (programi "Stop ekonomisë gri", programi pilot "Më fuqizo dhe do kem sukses" (2018), Programet pilot "Të rinjtë janë potenciali ynë" (2016).

Sesionet e zhvilluara gjatë procesit të hartimit të Planit Lokal të Punësueshmërisë së të Rinjve synonin të hulumtojnë masat ekzistuese dhe të propozojnë masa të tjera alternative në formën e shërbimeve për të rinj, që do të kontribuojnë në rritjen e konkurrencës së të rinjve në kërkimin e punës. Politika aktive e punësimin, vetëpunësimi, rikualifikimi dhe trajnimi shtesë, punësimi sezonal, aftësitë digjitale dhe sipërmarrëse, janë vetëm disa nga temat që u trajtuan në punën e drejtpërdrejtë me të rinjtë në Ulqin gjatë këtij procesi.

Politika e punësimin të të rinjve duhet të jetë fokusi i pothuajse të gjitha aktiviteteve që kryhen në nivel lokal dhe shtetëror. Përmes formave të arsimit të dyfishtë, klubeve të sipërmarrjes, programeve të aftësimin profesional dhe formave të ndryshme të arsimit joformal, synohet të ndikohet pozitivisht në kualifikimet e të rinjve dhe të rritet konkurrueshmëria e tyre në tregun e punës.

Komuna e Ulqinit ka miratuar *Strategjinë e Punësimin për periudhën 2021-2025*. Kjo strategji synon harmonizimin e prioriteteve dhe qëllimeve të strategjive komunale për punësim dhe zhvillim të burimeve njerëzore me kornizën strategjike kombëtare, dmth. Strategjia Kombëtare për Punësimin dhe Zhvillimin e Burimeve Njerëzore 2016-2020 si dhe dokumente të tjera relevante strategjike të Malit të Zi lidhur me punësimin, arsimin dhe përjashtimin social.

Prioritetet e Strategjisë Kombëtare relevante për tregun lokal të punës të Komunës së Ulqinit janë:

- Rritja e punësimin - ulja e shkallës së papunësisë
- Funkcionimi efikas i tregut të punës
- Përmirësimi i kualifikimeve dhe kompetencave në përputhje me nevojat e tregut të punës
- Promovimi i përfshirjes sociale dhe reduktimi i varfërisë

Ligji për arsimin dhe edukimin fillor përcakton që orientimi në karrierë është një nga qëllimet e arsimit në shkollën fillore.

Ligji për Arsimin Profesional përcakton qëllimet e orientimit profesional si "sigurimi i njohurive dhe aftësive të nevojshme për jetën dhe punën, interesat personale, zhvillimin profesional të një personi për arsimim të mëtejshëm" dhe "mundësimi i orientimit në karrierë".





This project is funded by
the European Union



MNE-ALB
IPA CROSS-BORDER COOPERATION PROGRAMME
MONTENEGRO-ALBANIA 2014-2020



Crna Gora
Ministarstvo javne uprave

Ligji për Kualifikimet Profesionale Kombëtare përcakton një sërë institucionesh që në kuadër të kompetencave të tyre monitorojnë dhe analizojnë nevojat e tregut të punës dhe informojnë e këshillojnë kandidatët dhe punëdhënësit e interesuar.

Ligji për Kornizën Kombëtare të Kualifikimeve ka për qëllim mundësimin e të mësuarit gjatë gjithë jetës dhe marrjen e kualifikimeve, e cila është e rëndësishme për orientimin në karrierë.

Ligji për Punësimin dhe Ushtrimin e të Drejtave të Sigurimit nga Papunësia nga viti 2010, përcakton orientimin profesional dhe këshillimin për planifikimin e karrierës si një nga aktivitetet në fushën e punësimit.

Strategjia për Zhvillimin e Ndërmarrjeve Mikro, të Vogla dhe të Mesme për periudhën 2018-2022 thekson nevojën e krijimit të kushteve në mënyrë që të rinjtë, gratë dhe kategoritë e popullatës që vështirë punësohen, të mund të zgjerojnë potencialet e tyre ekonomike përmes punësimit më të mirë dhe të zhvillimit të potencialeve sipërmarrëse në Mal të Zi. Në këtë kontekst, në kuadër të kësaj strategjie janë definuar prioritetet e mëposhtme:

- Përmirësimi i mjedisit institucional dhe aksesit në financa;
- Sigurimi i njohurive dhe aftësive të nevojshme;
- Promovimi, rrjetëzimi dhe avokimi i interesave të grave, të rinjve dhe sipërmarrësve socialë

Programi për Zhvillimin e Turizmit Rural të Malit të Zi me Planin e Veprimit deri në vitin 2021 ka përcaktuar një sërë prioritetesh, duke përfshirë përforcimin e qëndrueshmërisë së sipërmarrjes rurale, me pesë masa shoqëruese. Në pjesën që lidhet me mbështetjen dhe nxitjen e brezit të ri për t'u kthyer në fshat, ky program parashikon mbështetjen e të rinjve për tu angazhuar në agroturizëm (nxitja e zhvillimit rural përmes granteve apo fondeve për sipërmarrësit e rinj) dhe më pas nxitja e sipërmarrjes së grave - sidomos për shkak se praktika ka treguar në periudhën e mëparshme që gratë në Mal të Zi janë shtylla kryesore e shërbimeve në agroturizëm.

Hulumtime e kryera në fushën e punësueshmërisë së të rinjve në komunën e Ulqinit

Në bazë të analizës së të dhënave nga burimet dytësore të informacionit dhe njohjes së të situatës në tregun lokal të punës, anëtarët e *Partneritetit Lokal të Punësimit* përcaktuan se grupi i të rinjve nën 30 vjeç është një nga grupet më të pafavorizuara në tregun vendor të punës.

Mungesa e motivimit për arsimim shtesë, pasiviteti i të rinjve, njohja e pamjaftueshme e gjuhës zyrtare, natyra sezonale e punësimit, profesionet e mangëta, paragjykimet, mosinvestimi në zhvillimin e fuqisë punëtore, janë disa nga dobësitë e identifikuar në analizën SWOT të punuar për zhvillimin e Strategjisë.





Disa nga aktivitetet e propozuara nga Strategjia që do të kontribuonin në përmirësimin e pozitës së të rinjve në tregun e punës janë:

- Organizimi i tryezave të rumbullakëta për tema të ndryshme që lidhen me funksionimin e subjekteve ekonomike
 - Realizimi i trajnimeve për sipërmarrës dhe për persona që fillojnë një biznes të ri
 - Përvetësimi i njohurive dhe aftësive të punës - përmes programeve të praktikës
 - Përvetësimi i njohurive dhe aftësive që kërkohen në tregun e punës
 - Organizimi i një panairi punësimi me fokus turizmin
 - Zbatimi i programeve të orientimit në karrierë në shkollat e mesme
 - Realizimi i trajnimeve mbi kompetencat digjitale dhe sipërmarrëse
 - Sesione edukative dhe motivuese në internet për sipërmarrësit e rinj dhe organizimi i një konkursi rinor për idenë më të mirë të biznesit
- Stimujt për punësim në bujqësi dhe turizëm për të afirmuar bujqësinë dhe turizmin si sektor të dëshirueshëm për punësim.
 - Mbështetje për sipërmarrjen e të rinjve (mbështetje përmes ndarjes së granteve për fillimin e biznesit - të rinjtë deri në 30 vjeç)
 - Ngritja e qendrave informative për punësim dhe këshillim për karrierë
 - Aftësimi tek punëdhënësit dhe krijimi i vendeve të punës nga thirrjet për komunat më pak të zhvilluara

Hulumtimet e mëparshme për nevojat e të rinjve në Ulqin tregojnë pa mëdyshje për problemet thelbësore me të cilat ballafaqohen të rinjtë dhe për programet që i nevojiten qytetit. Të rinjtë duan një qytet me disa fakultete, më shumë drejtime në shkollën e mesme, mundësi për tu informuar për programe më të mira arsimore, aktivitete jashtëshkollore, për të drejtat dhe pjesëmarrjen e të rinjve në jetën shoqërore; një qytet ku ata mund ta shijojnë kohën e tyre të lirë gjatë gjithë vitit; një qytet në të cilin të rinjtë pyeten dhe mendimi i tyre merret parasysh.

Të rinjtë besojnë se papunësia është një nga problemet më të mëdha dhe si masa për luftimin e saj sugjerojnë futjen e orientimit profesional në shkollat fillore dhe të mesme në Ulqin (26%), masa që detyrojnë punëdhënësit të ofrojnë mundësi për të rinjtë (23%) praktika, programe rikualifikimi (21%), stimulimi i vullnetarizmit (15%) dhe ofrimi i kredive të favorshme për fillestarët në biznes (15%).

Për të kuptuar situatën në lidhje me punësimin e të rinjve në komunën e Ulqinit, me vlerë janë rezultatet e hulumtimit për kërkesat e tregut të punës për të rinjtë, të zhvilluar nga OJQ Horizonti i Ri. Në bazë të rezultateve të përfituara nga hulumtimi për kërkesat e tregut të punës për të rinjtë, mund të konstatohet se: pothuajse të gjitha subjektet turistike të anketuara në Ulqin janë të gatshme të pranojnë praktikantë në kompanitë e tyre. Shumica e tyre deklaruan se kanë nevojë për praktikantë për pozicionet si: kamerier, banakier, komercialist, kuzhinier, recepsionist, menaxher etj. Bazuar në të dhënat e marra, mund të shohim se dy metodat më të shpeshta të përdorura nga punëdhënësit në Ulqin për të gjetur





This project is funded by
the European Union



MNE-ALB
IPA CROSS-BORDER COOPERATION PROGRAMME
MONTENEGRO-ALBANIA 2014-2020



Crna Gora
Ministarstvo javne uprave

punonjësit e rinj janë: përmes rrjeteve sociale dhe aplikacioneve (40%) si dhe përmes shpalljeve (30%)

Kjo e dhënë tregon për aktualitetin e rrjeteve sociale dhe përdorimin e tyre edhe në këtë fushë. Krahas pozitive që rezultuan të rëndësishme (kamerier, kuzhinier etj.) në pyetjen e mëparshme, për punëdhënësit kanë rëndësi të konsiderueshme pozitat si ekonomist, cicëron, ekspert IT, ekspert i marketingut digjital, d.m.th. ata ndihen të gatshëm t'i përfshijnë këto pozicione në strukturën e kompanive të tyre. Punëdhënësit kanë identifikuar aftësitë më të rëndësishme të jetës që duhet të ketë një punonjës: përgjegjësi personale, aftësi për bashkëpunim, punë në grup, respekt për veten dhe të tjerët, etj. Ndërsa aftësitë e buta më të rëndësishme për punëdhënësit janë: qëndrimi pozitiv, menaxhimi i kohës, përgjegjësia, fleksibiliteti, lidhshipin, inovacioni etj.. Secila nga të dhënat e marra përfaqëson informacion të dobishëm për të rinjtë, në bazë të të cilave ata mund të konkludojnë se cilat janë kërkesat e tregut që vlejné veçanërisht për ta.

Arsimi në shërbim të punësueshmërisë më të madhe të të rinjve në komunën e Ulqinit

Programet arsimore përcaktojnë metodat dhe format e punës në mësimdhënie, në mënyrë që t'u mundësohet nxënësve të arrijné rezultatet e planifikuara të të nxënit dhe të përfitojné njohuri të përhershme dhe të zbatueshme, kompetenca thelbësore dhe profesionale. Promovimi i mësimin në vendin e punës, krahas punës në një mjedis real pune, është i domosdoshëm për të zhvilluar aftësi dhe kompetenca cilësore, relevante për tregun e punës, të cilat mundësojnë zhvillimin personal dhe profesional të individit. Ashtu si në shumë komuna të Malit të Zi, problemi i mësimin praktik të pamjaftueshëm, rezultatet e të nxënit të cilët nuk janë vlerësuar në mënyrë adekuate, në Ulqin është prej kohësh evident dhe është potencuar nga disa të rinj të cilët kanë vënë re pasojat e modelit ekzistues të të mësuarit.

Për të inkurajuar kompanitë që të punësojnë punëtorë të rinj dhe shpesh të papërvojë në kohë të pasigurta ekonomike, duhet të ekzistojné stimuj realë në nivel lokal. Kjo përfshin një sistem arsimor që ofron aftësitë personale dhe profesionale të nevojshme për të filluar një karrierë, një sistem që përshtat trajnimin profesional me nevojat e tregut të punës dhe promovon një mentalitet sipërmarrës. Ekziston gjithashtu nevoja për një treg pune dinamik dhe gjithëpërfshirës, në të cilin të rinjtë të kenë aftësitë e nevojshme për një ekonomi konkurruese, kohezion social dhe rritje ekonomike afatgjate. Reformat për këtë qëllim duhet të vendosin një ekuilibër midis fleksibilitetit dhe sigurisë, gjë që arrihet më së miri përmes përfshirjes së partnerëve socialë.





This project is funded by
the European Union



MNE-ALB
IPA CROSS-BORDER COOPERATION PROGRAMME
MONTENEGRO-ALBANIA 2014-2020



Crna Gora
Ministarstvo javne uprave

Të rinjtë në Ulqin duhet të ndihmohen nga këshilltarë të kualifikuar për karrierë në procesin e zgjedhjes së profesionit të ardhshëm. Shërbimet publike të punësimit luajnë gjithashtu një rol të rëndësishëm në kalimin nga shkolla në punë.

Modelet e përfshirjes së orientimit në karrierë në kurrikulën shkollore janë të ndryshme: si lëndë e posaçme e detyrueshme, si lëndë e ndërthurur me një lëndë tjetër, si lëndë zgjedhore, si temë ndërkurrikulare apo si kombinim i këtyre dhe disa mënyrave të tjera. Gjetja e një modeli të përshtatshëm është një detyrë që duhet përmirësuar më tej, duke pasur parasysh praktikën dhe përvojat pozitive nga periudha e zbatimit të Strategjisë së Orientimit të Karrierës në Mal të Zi (2011-2015).

Mungesa e standardeve të cilësisë në nivel kombëtar e bën të vështirë punën e ekipeve të shkollave për orientim në karrierë. Mekanizmat e bashkëpunimit ndërmjet ekipeve të shkollave dhe shërbimeve të Entit për Punësim që merren me orientimin në karrierë, nuk janë zhvilluar në masën e nevojshme. Në kuadër të Ministrisë së Arsimit, ka filluar të funksionojë në mars të vitit 2017 „Qendra Euroguidance“ – qendër për orientim dhe këshillim në karrierë, e cila do të zhvillojë aktivitete në fushën e këshillimit për karrierë dhe përmirësimin e bashkëpunimit ndërmjet shkollave, Entit për Punësimin dhe komuniteteve lokale.

Shkolla e mesme "Vëllazërim-Bashkim" është e vetmja shkollë në Ulqin që arsimon të rinjtë për drejtime të caktuara profesionale dhe teknike, por që ende nuk ka arritur të lidhet sa duhet me sektorin e biznesit dhe nuk ka arritur të krijojë një bashkëpunim institucional afatgjatë me sektorin hotelier, për të përvetësuar praktikën e nxënësve që u nevojitet për të zhvilluar kompetencat e tyre profesionale. Mungesa e përvojës së punës është arsyeja kryesore pse kompanitë hezitojnë të punësojnë të rinjtë në kohë të vështira ekonomike.

Mësimi teorik, pa detyrimin për të zbatuar atë që është mësuar, po rezulton gjithnjë e më shumë si pengesë për kyçjen në tregun e punës. Punëdhënësit në mesin e sezonit turistik në Ulqin nuk kanë kohë e as kapacitet për të trajnuar punëtorë dhe gjatë vitit nuk mendojnë të investojnë në staf që do t'u sillte fitime të shumëfishta në një periudhë afatgjate. Interesat afatshkurtra, mungesa e njohurive menaxheriale dhe qasja strategjike e sektorit të biznesit ndikojnë negativisht tek të rinjtë në Ulqin, të cilët nuk kanë mundësi të praktikohen në punët që do të dëshironin të bënin në të ardhmen, të formohen me përvojë, por thjesht refuzohen dhe kështu demotivohen për konkurrencë të mëtejshme në treg.

Praktika e punës është një nga elementët më të rëndësishëm e hyrjes së të rinjve në tregun e punës dhe suksesi i tyre varet nga një partneritet i gjerë social që bashkon përfaqësues të biznesit dhe institucionet arsimore. Vazhdimësia e këtij procesi është jashtëzakonisht e rëndësishme. Kjo duhet të bëhet një praktikë e mirë që do të jetësohet në Ulqin dhe do të zbatohet gjatë gjithë vitit. Me rastin e krijimit të një sistemi trajnimi të dyfishtë të përshtatur për nevojat e kompanive, tregut të punës dhe të rinjve, është e nevojshme që shkollat e mesme lokale në Ulqin të organizojnë dhe udhëheqin këtë proces në bashkëpunim të ngushtë me aktorët nga sektori i biznesit. Përfshirja e fortë e partnerëve social siguron që





ata të identifikohen dhe të mbështesin sistemin e trajnimit të dyfishtë. Punëdhënësit gjithashtu duhet të marrin përgjegjësi dhe të jenë të gatshëm të investojnë në këtë proces.

Njohja e rezultateve të të nxënësve, veçanërisht njohurive dhe aftësive të fituara përmes të mësuarit joformal, mund të luajë një rol të rëndësishëm në përmirësimin e punësueshmërisë dhe mobilitetit të të rinjve, si dhe në rritjen e motivimit për të mësuar gjatë gjithë jetës, veçanërisht të grupeve të rrezikuara sociale dhe ekonomike dhe atyre me kualifikime të ulëta profesionale. Duke pasur parasysh zhvillimin e përsheptuar të teknologjive të reja dhe krijimin e bizneseve të reja si dhe avancimin e dukshëm të bizneseve të vjetra, është e qartë se ka nevojë për inkurajim më të fortë të të rinjve për të rishqyrtuar mundësitë e tyre dhe për t'u përfshirë dukshëm më shumë në procesin e digjitalizimit. Investimi në njohuritë e veta dhe stafin e ri që do të pranojë dhe zbatojë procese të digjitalizuar të biznesit, është një parakusht i rëndësishëm pa të cilin është e pamundur të arrihet konkurrueshmëria e biznesit, zhvillimi i produktit cilësor dhe performanca e suksesshme në tregun vendas apo të huaj.

Shkollat e mesme dhe fakultetet në Ulqin

Shkolla e Mesme e Kombinuar "Vëllazërim-Bashkim"	Në këtë shkollë arsimohen nxënës për profesione të ndryshme arsimore si: teknik i ekonomisë, teknik i turizmit, kuzhinier, pastičier, elektroinstalues, parukier si dhe gjimnazi i përgjithshëm.
Gjimnazi Privat „Drita“	Shkolla e parë e mesme private në gjuhën shqipe - lloj i kolegjit që bazohet në planin programor të gjimnazit të përgjithshëm. Në kuadër të aktiviteteve jashtëshkollore, kjo shkollë e mesme realizon për nxënësit e saj seksione të ndryshme.
Fakulteti Mesdhetar i Studimeve të Biznesit Ulqin	Nga shtatori i vitit 2014 në Ulqin është hapur departamenti i këtij institucioni të arsimit të lartë për edukimin e të rinjve në fushën e turizmit detar dhe aktiviteteve përbërëse të tij. Fakulteti i Studimeve të Biznesit Mesdhetar organizon kurrikulat e tij në tre programe studimi: Menaxhim në Turizëm Detar, Sport dhe Rekreacion, Menaxhim në Dogana, Transport mallrash dhe Biznes Agjencie dhe Menaxhimi dhe Siguria e Marinave dhe Jahteve.

Cilësia, aktualiteti dhe atraktiviteti i arsimit profesional kërkon monitorim dhe vlerësim të vazhdueshëm të punës edukativo-arsimore, sigurimin e cilësisë së lartë të mësimdhënies, zhvillimin e përsosmërisë të të gjitha formave të arsimit dhe aftësimit, sigurimin e zhvillimit të vazhdueshëm profesional të mësuesve dhe bashkëpunëtorëve për t'i bërë disa profesione





This project is funded by
the European Union



MNE-ALB
IPA CROSS-BORDER COOPERATION PROGRAMME
MONTENEGRO-ALBANIA 2014-2020



Crna Gora
Ministarstvo javne uprave

më tërheqëse për nxënësit. Krijimi i një politike në arsimin profesional dhe financimi i tij duhet të jetë përgjegjësi dhe detyrim i të gjithë pjesëmarrësve në proces: Qeverisë, punëdhënësve, organizatorëve të arsimit profesional, mësimdhënësve dhe nxënësve, sepse të gjithë kanë interes të përbashkët për bashkëpunim të ngushtë.

Në Ulqin duhet bërë më shumë përpjekje për promovimin e ndërmarrësisë përmes punës së përbashkët, sepse realiteti ekonomik është i tillë që shpeshherë si zgjidhje e vetme do të imponohen bizneset e vogla dhe programet e vetëpunësimit. Kjo është arsyeja pse është e nevojshme të zhvillohet një frymë sipërmarrëse që në bankat e shkollës. Siç u përmend më lart dhe u tregua gjatë punës së drejtpërdrejtë me të rinjtë e Ulqinit (workshope, trajnime, takime konsultative, fokus grupe, etj.), problemi më i madh i edukimit të të rinjve në Ulqin është lidhja e pamjaftueshme ndërmjet shkollës dhe sektorit të biznesit, e veçanërisht kompanive turistike, të cilat mund të kontribuojnë në përfitimin e përvojës së të rinjve në punë. Përveç mungesës së bashkëpunimit midis shkollës dhe sektorit të biznesit, veçanërisht kompanive turistike, problematikë mbetet monitorimi dhe cilësia e bërjes së praktikës së nxënësve. Shkolla e mesme ende nuk ka një sistem mjaft të zhvilluar të monitorimit të praktikës dhe kjo më së shpeshti përfundon vetëm me mbajtjen e ditarit të punës nga nxënësit që dëshmon kryerjen e praktikës.

Progresi në zhvillimin e frymës sipërmarrëse është një nga proceset që mund të ketë sukses vetëm nëpërmjet veprimit aktiv të të gjithë aktorëve në jetën sociale dhe ekonomike të Malit të Zi. Ekzistojnë shembuj të ndryshëm të praktikave të mira në shkollat e Malit të Zi se si të ushqehet shpirti sipërmarrës së të rinjve dhe si të inkurajohen të rinjtë që të përfshihen dhe të motivojnë nxënësit e tjerë për sipërmarrje. Kështu që do të ishte e nevojshme të krijohen mundësi të tilla për të rinjtë edhe në shkollën e mesme të Ulqinit. Për të gjitha këto, shkolla duhet të motivohet në radhë të parë dhe t'u ofrojë nxënësve një vend ku ata do të përvetësojnë njohuritë teorike dhe praktike në një sistem cilësor dhe të mirëorganizuar.

Krijimi i qendrave të sipërmarrjes dhe shërbimeve të ngjashme rinore kontribuon në motivimin e të rinjve përmes llojeve të ndryshme të mbështetjes për të mësuar më shumë për mundësitë e zhvillimit të biznesit privat dhe shanset për ta kthyer të ardhmen e tyre në atë drejtim. Në anën tjetër, ata mundësojnë lidhje më të mirë të shkollës dhe partnerëve socialë brenda territorit të komunës. Qendrat zhvillojnë shprehitë e punës së nxënësve, cilësitë morale dhe organizative, afirmojnë individualitetin, inkurajojnë kreativitetin dhe inovacionin, si dhe të menduarit krijues e kritik.

Zhvillimi i mendësisë sipërmarrëse në vendet e suksesshme ushqehet që në kopshtin e fëmijëve, përmes lëndëve në shkollat fillore dhe të mesme e deri te kolegjet për t'u dhënë mundësi të rinjve të fitojnë shprehitë e punës në kohën e duhur. Kjo sepse, ndërmarrësia pozicionohet si një mënyrë gjithnjë e më e pranuar për zgjidhjen e problemeve dhe si një strategji e vlefshme për krijimin e vendeve të punës, përmirësimin e standardit të jetesës dhe pavarësinë ekonomike të të rinjve.





This project is funded by
the European Union



MNE-ALB
IPA CROSS-BORDER COOPERATION PROGRAMME
MONTENEGRO-ALBANIA 2014-2020



Crna Gora
Ministarstvo javne uprave

Kufizimet buxhetore kërkojnë zgjidhje të re për të siguruar financim të qëndrueshëm të arsimit profesional dhe për të siguruar që burimet të përdoren në mënyrë efektive dhe të drejtë.

Plani Lokal i Punësueshmërisë të të Rinjve për Komunën e Ulqinit

Vizioni:

Komuna e Ulqinit – një vend me arsim cilësor dhe mundësi të barabarta punësimi për të gjithë të rinjtë

Misioni:

Partnerët social të komunës së Ulqinit përdorin burime të përbashkëta për të krijuar një rrjet të mbështetjes për të rinjtë në Ulqin me qëllim të rritjes së punësueshmërisë.

Përcaktimi i qëllimeve dhe aktiviteteve të planit të veprimit

Qëllimi kryesor: Përmirësimi i mundësive për punësim të të rinjve në komunën e Ulqinit

OBJEKTIVI 1: Rritja e punësueshmërisë së të rinjve përmes fuqizimit të kapaciteteve për të filluar një biznes

OBJEKTIVI 2: Harmonizimi i programeve formale dhe joformale për përvetësimin e njohurive dhe aftësive për kërkesat e tregut të punës

OBJEKTIVI 3: Rritja e mundësive për të rinjtë e moshës 15-30 vjeç për të fituar përvojën e tyre të parë të punës

OBJEKTIVI 4: Forcimi i bashkëpunimit në fushën e punësueshmërisë të të rinjve ndërmjet partnerëve socialë të njohur (institucionet arsimore, OJQ-të, dhoma zejtare, kompanitë hoteliere, organizata turistike, media...)





Plani njëvjeçar i veprimit për rritjen e punësueshmërisë së të rinjve nga Ulqini, me tregues dhe vlerësim të resurseve të nevojshme

Qëllimi strategjik 1: Rritja e punësueshmërisë së të rinjve përmes fuqizimit të kapaciteteve për të filluar një biznes

Qëllimi specifik 1.1: Rritja e kompetencave të të rinjve për të filluar një biznes

Aktivitet	Indikatorët	Përgjegjësia	Korniza kohore	Fondet
1.1.1 Organizimi i workshopeve për të rinjtë e shkollave të mesme - aftësitë dhe kompetencat në biznes	Të organizuara të paktën 2 seminare për të paktën 30 studentë	Shkolla e mesme "Vëllazërim Bashkim" Zyra e punës Komuna e Ulqinit Sektori i OJQ-ve	Tremujori I dhe III i vitit 2023	350.00
1.1.2 Organizimi i seminareve për të rinjtë e shkollave të mesme për të filluar biznesin e tyre.	Së paku 1 seminar për të paktën 30 pjesëmarrës	Shkolla e mesme "Vëllazërim Bashkim" Zyra e punës Komuna e Ulqinit Sektori i OJQ-ve	Tremujori I dhe III i vitit 2023	200.00
1.1.3 Organizimi i seminareve dyditore për të rinjtë për të identifikuar një ide biznesi	Të paktën 1 seminar për të paktën 30 pjesëmarrës	Shkolla e mesme "Vëllazërim Bashkim" Zyra e punës Komuna e Ulqinit Sektori i OJQ-ve	Tremujori I dhe III i vitit 2023	200.00
1.1.4 Organizimi i një trajnimi gjashtëditor për të rinjtë pas përfundimit të shkollës së mesme për të krijuar një plan biznesi	Të paktën 1 seminar për të paktën 30 pjesëmarrës	Shkolla e mesme "Vëllazërim Bashkim" (profesorët) Zyra e punës Komuna e Ulqinit Sektori i OJQ-ve	Tremujori I dhe III i vitit 2023	900.00
1.1.5 Organizimi i konkurseve për të rinjtë për planin më të mirë të biznesit	Së paku 1 konkurs i organizuar për të rinj nga Ulqini	Komuna e Ulqinit Shkollat e mesme Sektori i OJQ-ve	Tremujori I dhe III i vitit 2023	2,000.00

Qëllimi specifik 1.2: Krijimi i një fondi për të ndihmuar të rinjtë për fillimin e një biznesi

1.2.1 Krijimi i një shërbimi mbështetës në Komunën e Ulqinit (Sekretariati për Zhvillim Ekonomik) që do të merrej me rritjen	Kuadri ligjor i përcaktuar për kompetencat e zyrës Hapësirë pune e dedikuar Të punësuar të paktën një	Zyra e punës Komuna e Ulqinit Sektori i OJQ-ve	Tremujori III dhe IV i vitit 2023	10.000,00
---	---	---	-----------------------------------	-----------



e punësueshmërisë të të rinjve.	nëpunës në zyrë			
1.2.2 Krijimi i një Fondi ose sigurimi i një linje të veçantë buxhetore për start-up'et e të rinjve	Është themeluar fondi apo është planifikuar një linjë e posaçme buxhetore për vitin 2023, për të mbështetur idetë e biznesit të të rinjve në komunën e Ulqinit. Rregulla të përcaktuara për shpërndarjen e fondeve Është ngritur një komision për shpërndarjen e fondeve	Komuna e Ulqinit Partnerët socialë Sektori i biznesit	Tremujori III dhe IV i vitit 2023	20.000,00

Qëllimi strategjik 2: Harmonizimi i programeve formale dhe joformale për përvetësimin e njohurive dhe aftësive për kërkesat e tregut të punës

Qëllimi specifik 2.1: Përvetësimi i programeve të njohurive dhe aftësive në dispozicion të të rinjve në Ulqin që do t'u mundësojnë atyre të hyjnë më lehtë në tregun e punës

Aktivitetet	Indikatorët	Përgjegjësia	Korniza kohore	Fondet
2.1.1 Analiza e përshtatjes të arsimit në shkollat e mesme në Ulqin me nevojat e tregut vendor të punës	Analiza e kryer Rezultatet e publikuara	Komuna e Ulqinit Institucionet arsimore Sektori i biznesit OJQ	Tremujori I dhe II i vitit 2023	800.00
2.1.2 Krijimi i bazës së të dhënave në faqen e internetit për mundësitë e vullnetarizmit dhe kryerjes së trajnimeve praktike në Ulqin, komunat tjera dhe jashtë vendit.	Website-i i krijuar, rishikuar dhe përditësuar rregullisht me informacione për mundësinë e vullnetarizmit dhe kryerjes së trajnimeve praktike në Ulqin dhe komunat tjera dhe jashtë vendit. Janë nënshkruar 10 kontrata për trajnime praktike me	Komuna e Ulqinit Institucionet arsimore Sektori i biznesit OJQ	Tremujori IV i vitit 2023	500.00





	punëdhënësit në Ulqin aj.			
2.1.3 Përmirësimi i sistemit të mësimi praktik në shkolla	Janë nënshkruara 10 kontrata për trajnime praktike me punëdhënësit në Ulqin	Institucionet arsimore Sektori i biznesit OJQ	Tremujori I, II, III dhe IV i vitit 2023	200.00
2.1.4 Vlerësimi dhe vetëvlerësimi i mësimi praktik në shkolla	Evaluumi	Institucionet arsimore OJQ	Tremujori IV i vitit 2023	Linja e rregullt buxhetore
2.1.5 Krijimi i një sistemi të kontrollit të cilësisë të mësimi praktik tek punëdhënësin	Të krijuara standardet për kryerjen e trajnimeve praktike për nxënësit e shkollave të mesme dhe mentorët e tyre punëdhënës Të krijuar dhe të standardizuar ditarët e praktikës së punës Fletët e vlerësimi të krijuara për të rinjtë dhe punëdhënësit mbi përvojat praktike të trajnimit me rekomandime për praktikantët e ardhshme	Institucionet arsimore Sektori i biznesit OJQ	Tremujori I dhe II i vitit 2023	Si pjesë e aktiviteteve të rregullta të institucion eve arsimore dhe në bashkëpunim me partnerët social
2.1.6 Promovimi i mundësive për vullnetarizëm të të rinjve dhe kryerja e trajnimeve praktike tek punëdhënësit	Minimumi 5 ngjarje publike në dispozicion të të gjithë të rinjve të interesuar të Ulqinit të organizuara me temën e promovimit të punës vullnetare dhe trajnimit praktik.	Komuna e Ulqinit Institucionet arsimore Sektori i biznesit OJQ	Tremujori I, II, III dhe IV i vitit 2023	500.00
2.1.7 Krijimi dhe monitorimi i shërbimeve vullnetare dhe trajnimi praktik për nxënësit e shkollave të mesme në sektorin e OJQ-ve, institucioneve, sektorit privat.	Minimumi 2 shërbime të sapokrijuara për vullnetarizëm dhe/ose kryerjen e trajnimeve praktike tek punëdhënësi	Komuna e Ulqinit Institucionet arsimore Sektori i biznesit OJQ	Tremujori IV i vitit 2023	1000.00
Qëllimi specifik 2.2: Krijimi i këshillimit për karrierë për të rinjtë në Ulqin				
2.2.1 Organizimi i takimeve ndërmjet përfaqësuesve të	Raportim për të paktën 3 takime	Komuna e Ulqinit, Enti për Punësim Institucionet arsimore Sipërmarrësit	Tremujori I, II, III dhe IV i vitit 2023	Aktivitete të rregullta



Komunës së Ulqinit, zyrës së punës, shkollave dhe sipërmarrësve me qëllim të zhvillimit të një plani për zhvillimin e këshillimit për karrierë.	I krijuar plani i këshillimit për karrierë			
2.2.2 Forcimi i kapaciteteve të stafit mësimdhënës. Organizimi i trajnimit për mësimdhënës "Aftësitë e udhëheqjes në karrierë në shkollat e mesme profesionale"	Të paktën tre trajnime të organizuara për të paktën 30 mësues me temën "Aftësitë e udhëheqjes në karrierë në shkollat e mesme profesionale"	Institucionet arsimore	Deri në tremujorin e katërt të vitit 2023	1,500.00
2.2.3 Formimi i ekipeve për orientim dhe këshillim në karrierë në shkollat e mesme	Në secilën shkollë në Ulqin është formuar një ekip për këshillim për karrierë	Institucionet arsimore	Deri në tremujorin e katërt të vitit 2023	400.00
2.2.4 Hartimi i një plani vjetor pune për ekipin e orientimit dhe këshillimit në karrierë	Plani vjetor i punës së ekipit	Institucionet arsimore	Deri në tremujorin e katërt të vitit 2023	Aktivitete të rregullta
2.2.5 Organizimi i vizitave të nxënësve në kompani, vizita e ekspertëve në shkollë si pjesë e aktiviteteve jashtëshkollore.	Të paktën 15 vizita të organizuara të nxënësve tek punëdhënësit në nivel të komunës së Ulqinit	Institucionet arsimore Sektori i biznesit	Deri në tremujorin e katërt të vitit 2023	100.00
2.2.6 Organizimi i panairëve të arsimit dhe punësimit	Minimumi 2 panairë punësimi të organizuara për të rinjtë e Ulqinit	Komuna e Ulqinit Institucionet arsimore Sektori i biznesit OJQ	Deri në tremujorin e katërt të vitit 2023	1500.00
2.2.7 Organizimi i aktivitetit "Ditët e Karrierës"	Raporti nga aktiviteti "Ditët e Karrierës"	Komuna e Ulqinit Institucionet arsimore Sektori i biznesit OJQ	Tremujori II i vitit 2023	600.00



Qëllimi strategjik 3: Rritja e mundësive për të rinjtë e moshës 15-30 vjeç për të fituar përvojën e tyre të parë të punës

Qëllimi specifik 3.1: Përmirësimi i mjedisit mbështetës të të rinjve

Aktivitetet	Indikatorët	Përgjegjësia	Korniza kohore	Fondet
3.1.1 Identifikimi i sektorit privat dhe publik në Ulqin ku të rinjtë mund të fitojnë përvojën e tyre të parë të punës	Është krijuar një listë e punëdhënësve të parë potencialë për të rinjtë në Ulqin	Zyra për rritjen e punësueshmërisë – Komuna e Ulqinit	Tremujori IV i vitit 2023	Si pjesë e aktiviteteve të rregullta
3.1.2 Organizimi i seminareve për të rinjtë për të realizuar CV dhe intervistë pune	Të organizuara të paktën 3 punëtori për të rinjtë	Zyra për rritjen e punësueshmërisë – Komuna e Ulqinit	Tremujori IV i vitit 2023	450.00
3.1.3 Organizimi i trajnimeve për punëdhënësit që do të përfshihen në programin e përfitimit të përvojës së parë të të rinjve	Të organizuara të paktën 3 trajnime për punëdhënësit	Zyra për rritjen e punësueshmërisë – Komuna e Ulqinit	Tremujori IV i vitit 2023	450.00
3.1.4 Organizimi i ditëve të „dyerve të hapura“ tek punëdhënësit	Raporte nga të paktën 5 ngjarje të organizuara	Sektori i biznesit OJQ	Tremujori III i vitit 2023	100.00

Qëllimi strategjik 4: Forcimi i bashkëpunimit në fushën e punësimit të të rinjve ndërmjet partnerëve socialë (institucione arsimore, OJQ, dhoma zeytare, kompani hotelerike, organizata turistike, media...)

Qëllimi specifik 4.1: Përmirësimi i bashkëpunimit të partnerëve socialë në nivelin lokal

Aktivitetet	Indikatorët	Përgjegjësia	Korniza kohore	Mjetet
4.1.1 Tryezë e rrumbullakët me temën e punësueshmërisë së të rinjve nga Ulqini, për përfaqësuesit e partnerëve të njohur social në nivel lokal	Ngjarje e realizuar Nënshkruhet memorandum i bashkëpunimit	Komuna e Ulqinit Partnerët socialë	Tremujori II i vitit 2023	500.00
4.1.2 Takim pune i institucioneve	Takimi i realizuar	Komuna e Ulqinit,	Tremujori II i vitit 2023	500.00





arsimore të Ulqinit dhe subjekteve relevante shtetërore, për të vlerësuar nevojën e futjes së programeve dhe drejtimeve të reja arsimore në shkollat e mesme dhe fakultete.	Përfundimet nga takimi	Institucionet arsimore Ministria e Arsimit Enti për Punësim Qendra e Arsimit Profesional		
---	------------------------	---	--	--

Hartimi planit për monitorimin e zbatimit të Planit Lokal dhe suksesit të tij

Plani i Veprimit të Punësueshmërisë së të Rinjve pa një mekanizëm për monitorimin e zbatimit të planit dhe suksesit të tij nuk mund të jetë cilësorë. Monitorimi paraqet përcjelljen e realizimit të një sërë aktiviteteve të planifikuara me këtë dokument dhe në bazë të këtyre monitorimeve do të përcaktohet sukcesi i aktiviteteve, do të konfirmohen bartësit e aktiviteteve apo palët përgjegjëse për zbatimin, periudhën e zbatimit dhe fondet e shpenzuara. Evaluimi do të konsistojë në një vlerësim sipas kriterëve ose standardeve të përcaktuara dhe një vlerësim të aktiviteteve të planifikuara nga ky plan dhe rezultateve të tyre.

Ky dokument e sheh zyrën e sapoformuar në Komunën e Ulqinit, e cila merret me rritjen e punësueshmërisë së të rinjve, si bartëse të këtij procesi dhe faktor kyç në realizimin e suksesshëm të aktiviteteve të planit.

Monitorimi dhe vlerësimi i Planit Lokal të Punësimin të të rinjve ka dy objektiva kryesore:

- Vlerësimi i suksesit të arritjes së qëllimeve të Planit,
- Monitorimi i efikasitetit të zbatimit të aktiviteteve të përcaktuara në Plan.

Për arritjen e këtyre synimeve është e nevojshme ngritja e kapaciteteve të forta në nivel lokal, përmes të cilave do të sigurohej zbatimi i suksesshëm dhe veçanërisht monitorimi dhe vlerësimi i tij.

Në procesin e monitorimit dhe vlerësimit të zbatimit të Planit të Veprimit, do të ishte e dëshirueshme që të formoheshin grupe pune, të cilat do të ngarkohen me monitorimin dhe vlerësimin e fushave përkatëse.

Zbatimi i masave do të monitorohet sipas aktiviteteve specifike të përcaktuara dhe sukcesi do të përcaktohet sipas treguesve të përcaktuar. Raporti, përveç përshkrimit të aktivitetit me të cilin është zbatuar masa, do të përmbajë edhe palët e interesuara, partnerët, qëllimet,





This project is funded by
the European Union



MNE-ALB
IPA CROSS-BORDER COOPERATION PROGRAMME
MONTENEGRO-ALBANIA 2014-2020



Crna Gora
Ministarstvo javne uprave

grupet e synuara, burimet e verifikimit dhe kornizën kohore dhe do t'u dërgohet të gjithë pjesëmarrësve në procesin e zbatimit të planit të punësueshmërisë të të rinjve në Ulqin.

ANËTARËT E GRUPIT PUNUES:

1. Sabra Deçeviq – trajnere/facilituese
2. Diandra Koçan
3. Amra Demiroviq
4. Arbër Seferi
5. Sanja Çausheviq
6. Tatjana Obradoviq
7. Linda Mollabeqiri
8. Harris Koçan
9. Edita Kovaçeviq
10. Kristina Nrekiq
11. Edita Kovaçeviq
12. Hera Kurti
13. Samir Dema

■ *Ky grup pune është formuar ekskluzivisht me aktivistë rinorë dhe përfaqëson qëndrime dhe pikëpamjet e të rinjve në komunitetin lokal lidhur me problemin e punësimit në nivel lokal dhe më gjerë.*

Dokumenti i dorëzohet Qeverisjes Vendore dhe institucioneve të tjera publike me qëllim të dhënies së sugjerimeve dhe mendimeve për miratimin përfundimtar dhe zbatimin e tij.

■ *Hartimi i këtij dokumenti është pjesë e projektit "Rrugët e zhvillimit të karrierës: Përgatitja e të rinjve nga Shqipëria dhe Mali i Zi për mundësitë e karrierës në sektorin e turizmit" i cili zbatohet me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian në kuadër të IPA II Mali i Zi-Shqipëri: Programi i Bashkëpunimit Ndërkufitar 2014-2020, i cili menaxhohet nga Ministria e Financave e Malit të Zi. Projekti zbatohet nga organizata World Vision Albania në partneritet me OJQ Horizonti i Ri, si dhe shkollat e mesme "Vëllazërim-bashkim" nga Ulqini dhe "Hamdi Bushati" nga Shkodra. Projekti bashkëfinancohet nga Ministria e Administratës Publike e Malit të Zi.*

